

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK

STUDIME POSTDIPLOMIKE

PROGRAMI - E DREJTA CIVILE DHE PRONËSORE



PUNIMI I DIPLOMËS MASTER

**TEMA: “ALIMENTACIONI DHE PROBLEMET PRAKTIKE NË
REALIZIMIN E KËSAJ TË DREJTE”**

Mentori:

Prof. Asoc. Dr. Bedri Bahtiri

Kandidatja:

Fjolla Zejnullahu

Prishtinë, maj 2024

Abstrakt

Alimentacioni është një institut i cili kontribuon në adresimin e pabarazive ekonomike mes bashkëshortëve pas divorcit. Qëllimi i këtij instituti mbetet në vendosjen e një balanci mes bashkëshortëve dhe sigurimin që pasojat e ndarjes së roleve brenda martesës të mos i bart vetëm njëra palë. Rrjedhimisht, alimentacioni synon që të evitohet situatën ku njëra palë del vetëm e fituar nga divorci kurse pala tjetër del vetëm e humbur, për shkak të ofrimit të mbështetjes së familjes gjatë martesës në forma të ndryshme.

Përkundër rëndësisë së pamohueshme të këtij instituti, janë evidente problemet ligjore dhe praktike të cilat e bëjnë të pamundur realizimin e kësaj të drejte. Kjo ndikon në veçanti në krijimin e pasojave dhe problemeve jo vetëm financiare të atyre personave të cilët kanë kontribuar në martesë në rolin e kujdestarit të familjes dhe punëve të shtëpisë, duke i bërë ata që të janë të varur nga mëshira e personave të tjerë. Qëllimi i rregullimit të problemeve ekzistuese lidhur me të drejtën e alimentacionit, nuk është as inkurajimi dhe as dekurajimi i personave në ndërmarrjen e rolit të kujdestarit të familjes dhe punëve të shtëpisë, por në njohjen e vlerës së kësaj pune për personat që vendosin të ndërmarrin një rol të tillë.

Në dekadat e fundit, problemi i mungesës së realizimit të alimentacionit është prezent si në shkallë kombëtare ashtu dhe në atë ndërkombëtare. Përkundër kësaj, nuk shihet të ketë përpjekje serioze në identifikimin, analizimin dhe adresimin e këtyre problemeve. Mos zgjidhja e problemeve në dimension të realizimit të të drejtës së alimentacionit sjell në denigrimin dhe penalizimin e personave, të cilët kanë vendosur ose që rrethanat ia kanë imponuar, që të lënë anash aspiratat në karrierë për të ofruar kontributin e tyre në formë të kujdesit për anëtarët e familjes.

Rëndësia e funksionimit të rregullt të këtij instituti dhe realizimit të të drejtës së alimentacionit është e pamohueshme. Ky është një institut juridik i një karakteri të veçantë që palës i mundëson një mbështetje pas divorcit, në periudhën tranzicionale drejt një fillimi të ri. Mirëpo, përkundër rëndësisë kryesore të këtij instituti, në praktikë paraqiten probleme të shumta sa i përket realizimit të kësaj të drejte.

Ky punim shtjellon aspektin teorik, krahasimor dhe praktik të problemeve ekzistuese lidhur me institutin juridik të alimentacionit, si dhe ofron rekomandime në mënyrë që kjo e drejtë të jetësohet dhe të mos mbes vetëm e shkruar në letër.

Fjalët kyçe: alimentacion, kujdestar i familjes, pabarazi ekonomike, probleme ligjore dhe procedurale.